



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 30.03.2023

Nr: 35

Ora: 13:00

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 38, DATË 27.03.2023 TË DEPOZITUAR NGA QENDRA "QËNDRESA QYTETARE"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 30.03.2023, me pjesëmarrjen e:

Ledio BRAHO - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: Qendra "Qëndresa Qytetare", përfaqësuar nga z. Rigels Xhemollari

OBJEKT: Kundërshtim i vendimit nr. 199, datë 24.03.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

BAZË LIGJORE: Nenet 21/b, 123/1, 124/1, 126 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar dhe të

neneve 9 dhe 10 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Qendra “Qëndresa Qytetare” ka depozituar pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve kërkesën ankimore, e cila është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 38 regj., datë 29.03.2023.

Në mbledhjen e datës 30.03.2023, ora 13:00, pas relatimit të anëtarit Ledio Braho, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 38 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementët e përcaktuar në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve,

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 38, datë 27.03.2023 të paraqitur nga Qendra “Qëndresa Qytetare”.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 04.04.2023 ora 12:30.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Ledio BRAHO - **Relator**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**